

REAGIM

NDAJ VENDIMIT TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR SHPENZIMIN E MJETEVE FINANCIARE NË VLERË PREJ 500.000 EURO PËR FONDIN PËR KUADRO NË NIVEL QENDROR

**ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS KËRKON
NDËRPRERJEN E RRYTJES SË KOMODITETIT NË NIVEL
QENDROR DHE KTHIMIN E VËMENDJES NDAJ KOMUNAVE**



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Buletini

Publikim dymujor • Viti XII • Nr.74 • Shtator - Tetor 2015



**Këshilli i Kryetarëve
debaton me dy ministri
të Qeverisë së Kosovës**

**Ministria e Financave garan-
ton AKK-në se deficitin prej mbi
10.5 milion euro për komunat
për vitin 2016 do të mbulohet
nga Qeveria**



**Asociacioni i Komunave të Kosovës ka bërë nominimin
e kandidatëve të komunave për anëtarë të Bordeve të
Ndërmarrjeve Publike të Ujit**

**Implementohen tri
projektet në komunat
fituese të 'Skemës BEACON'**



Ministria e Financave garanton AKK-në se deficiti prej mbi 10.5 milion euro për komunat për vitin 2016 do të mbulohet nga Qeveria

Në bazë të aktiviteteve dhe lobimit të fuqishëm të AKK-së, zëvendës Ministri i Financave z. Agim Krasniqi në debatin në televizion me Kryetarin e AKK-së z. Naim Ismajli dhe me anëtarin e Bordit të AKK-së z. Agron Kuçi u zotua se deficiti buxhetor për komunat e Kosovës për vitin 2016 i cili është më shumë se 10.500.000 euro do të mbulohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Vlen të ceket se kjo ndikoj edhe nga lobimi dhe reagimi i AKK-së rreth shpenzimeve të Qeverisë për shpenzime në paga për të ashtuquajturin “kuadër deficitar në nivel qendror”.

Në reagimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës ditë më parë ndër të tjera thuhej: “Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka analizuar me vëmendje vendimin e djeshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës ku është marrë vendimi (i cili ka qenë i pezulluar në janar të vitit 2015) për kthim në fuqi të Fondit për kuadro ku me automatizëm do të “shpërblehen” zyrtar të Qeverisë Qendrore me ngritje të pagës dhe ku ky shpenzim në total për këtë vit do të jetë në vlerë prej 500.000 EURO. Ky vendim konsiderohet që është marrë në kohën kur komunave të Kosovës për vitin 2016 do t’iu



shkurtohen buxhetet komunale në kategoritë: paga dhe medijtje, subvencione, investime kapitale etj. Duhet të theksohet që vetëm për paga dhe medijtje komunave të Kosovës do t’i shkurtohen buxhetet në vlerë prej 10.874.929 EURO. AKK-ja konsideron që Qeveria e Kosovës duhet në mënyrë shumë më serioze t’i marrë në konsideratë vërejtjet dhe kërkesat e kryetarëve të komunave rreth çështjeve të adresuara në Qeverinë e Kosovës, përkatësisht në Ministrinë e Financave. Në asnjë mënyrë nuk mund të lejohet një veprim i tillë pra, ngritja e pagave për zyrtar qeveritar

dhe shtimi i komoditetit në nivel qendror, kur në komuna kemi shkurtime buxhetore të larta të cilat ndikojnë në deficitin e pagave në arsimin fillor dhe të mesëm dhe me këto buxhete komunave iu lejohet ofrimi i shërbimeve minimale ndaj qytetarëve dhe duke mos marrë parasysh në asnjë mënyrë situatën alarmante në komuna në planin e investimeve si dhe pagave dhe medijtjeve të cilat do të shkaktojnë probleme shumë serioze në funksionim e pushtetit lokal në tërësi e në veçanti sistemit arsimor dhe shëndetësor në nivel lokal”.



FOTOLAJM

Asociacioni i Komunave të Kosovës, organizojë takimin e Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor, me qëllim të shqyrtimit të Projektligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Të gjitha plotësimet, vërejtjet dhe rekomandimet e komunave u dërguan në Departamentin Ligjor të Ministrisë së Administratës Publike.

Kryetari i komunës së Gjilanit dhe i Podujevës nënshkruajnë Konventën e Kryetarëve në Parlamentin Evropian



Edhe zyrtarisht komuna e Gjilanit dhe komuna e Podujevës janë anëtarësuar në Konventën e Kryetarëve – një lëvizje Evropiane që përfshinë autoritetet lokale dhe rajonale.

Sot me datën 15 tetor 2015, në ambientet e Parlamentit Evropian, kryetari i komunës së Gjilanit z.Lutfi Haziri dhe kryetari i komunës së Podujevës z.Agim Veliu kanë nënshkruar aktin e anëtarësimit të këtyre dy komunave në Konventën e Kryetarëve të Komisionit Evropian. Ky anëtarësim vjen me ndërmjetësimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës me institucionet evropiane dhe me mbështetjen e organizatës gjermane GIZ / Fondi Rajonal i Hapur dhe SDC.

Kjo është edhe një arritje e Asociacionit të Komunave të Kosovës në lobimin dhe ofrimin e shërbimeve në sferën ndërkombëtare për autoritetet lokale në Republikën e Kosovës. Duhet potencuar se AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës, është Anëtar i Përherëshëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON, pastaj në pozitën Asociacion i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

Vlen të ceket se Konventa e Kryetarëve është një lëvizje Evropiane që përfshinë autoritetet lokale dhe rajonale, të angazhuar në mënyrë vullnetare për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në territoret e tyre.

Nënshkruarit përfaqësojnë qytete, me madhësi të ndryshme duke filluar nga fshatra me madhësi të vogël e deri në zona kryesore metropolitane si Londra apo Parisi, që kanë nënshkruar Konventën e Kryetarëve të Komunave. Në vitin 2008, pas miratimit, të Pakos së BE-së për Klimë dhe Energji, Komisioni Evropian lansoi Konventën e Kryetarëve të Komunave për të miratuar dhe të mbështesë përpjekjet e vendosura nga autoritetet lokale në zbatimin e politikave të qëndrueshme të energjisë. Për karakteristikat e saja unike – duke qenë lëvizja e vetme e këtij lloji rreth mobilizimit të akterëve lokal dhe rajonal rreth përmbytjes së objektivave të BE-së – Konventa e Kryetarëve është portretizuar nga institucionet evropiane si një model i jashtëzakonshëm i një qeverisjeje shumë-nivelesh.

Zhvillimet e projektit ‘Eficiencia e Energjisë në Asociacionet e Komunave’

Në zyrën e AKK-së u mbajt takimi i radhës i projektit “Eficiencia e Energjisë në Asociacionet e Komunave (EeMA)”. Në takim ishin prezent z.Avni Sfishta nga GLZ-i, znj.Liridona Ponosheci nga AKK-ja, ekspertët e angazhuar për Asociacionin e Komunave për zhvillimin e SEAP-it: z. Naser Sahiti – Kryesuesi i Ekspertëve, z. Petrit Krasniqi për Komunën e Podujevës, z. Bujar Zeneli dhe z. Driton Thaçi për komunën e Prishtinës, z. Bekim Bajrami për Komunën e Gjilanit, si dhe z. Rasim Fejza – zyrtar nga Komuna e Podujevës, znj. Krenare Shkodra – zyrtare nga Komuna e Prishtinës dhe z. Azem Mujku – zyrtar nga Komuna e Gjilanit.

Në këtë takim u diskutua rreth angazhimit të ekspertëve në mbledhjen dhe plotësimin e tabelave për komunat e tyre përkatëse. Kështu që zhvillimi i SEAP-it është duke shkuar paralel në tri komunat dhe gati të gjithë kapitujt janë kompletuar. Sa i përket kapitullit të fundit “Masat” – është përgatitur drafti i parë dhe në takim u diskutua dhe u dakorduan rreth këtyre masave dhe në këtë mënyrë mund të thuhet se edhe ky kapitull është në përfundim të tij. Deri në fund të muajit tetor ose në mes të muajit nëntor, të gjitha SEAP-at do të kompletohen dhe do të përkthehen në gjuhën shqipe. Me pas u diskutua edhe për nënshkrimin e iniciativës së Konventës së Kryetarëve, ku Komuna e Podujevës dhe Komuna e Gjilanit kanë pranuar të jenë pjesë e Konventës së Kryetarëve dhe me 15 Tetor 2015 do të udhëtojnë për në Bruksel për nënshkrimin e kësaj Konvente. Gjithashtu edhe broshura (Road Map) është përkthyer dhe shtypur në gjuhën shqipe si dhe shpërndarja e tyre tek komunat do të bëhet në takimin e ardhshëm të Kolegjiut të AKK-së për Shërbime Publike.

Këshilli i Kryetarëve debaton me dy ministri të Qeverisë së Kosovës

Këshilli i Kryetarëve pranë Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) mbajti takimin e rradhës e ku morën pjesë edhe ministri i Ministrisë së Administratës Publike (MAP) z.Mahir Jagxhillar dhe Zëvendës Ministri i Ministrisë së Financave (MF) z.Isni Kilaj. Në këtë takim, të Këshillit të Kryetarëve u debatua lidhur me Projektligjin për Paga dhe sfidat e Qarkorës Buxhetore dhe ndryshimet për të ardhmen.

Takimin e hapi kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Naim Ismajli i cili tha se do të debatojmë për Projektligjin për Paga i cili është diskutuar disa herë deri më tani në forume të ndryshme që të dëgjohet zëri i komunave të Kosovës. Ju jeni të informuar me konkluzionet e nxjerra nga strukturat profesionale të AKK-së në mënyrë që ky ligj të bëhet më i implementueshëm në praktikë. Poashtu, kryetari Ismajli shtoi se do të diskutojmë lidhur me Qarkoren e Dytë Buxhetore lidhur me disa çështje që ka mundësi të përmirësohen në këtë Qarkore.

Duke marrë fjalën në këtë takim,



ministri i MAP-it z.Mahir Jagxhillar tha se – mirëpres këtë takim sepse kemi nevojë të diskutojmë temat të dy nivelet e qeverisjes në Kosovë. Ligji për pagat do të jetë unik, që rregullonj çështjen e pagave për gjithë përfituesit e pagave nga buxheti. Poashtu do të rregullohet termat e lloj-llojshme që ekzistojnë tani nëpër pozita. Në anën tjetër kemi edhe kufizike buxhetore dhe gjitha kërkesat dhe pritjet nuk mund të realizohen por vetëm të mos kemi tejkalime. Edhe me Bordin e AKK-së kemi pasur takime dhe disa kërkesa janë reale disa të tjera janë në shqyr-

tim. Çështja e këshilltarëve komunal nuk mund të rregullohet me këtë ligj.

Kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli duke potencuar edhe një herë qëndrimin zyrtar, ku ceku detajisht kërkesat, shtoi se kryetarët e komunave dhe pjesa tjetër udhëheqëse e komunës nuk kërkojnë rritje të pagës, por trajtim dinjitoz në harmoni me detyrat dhe përgjegjësitë e sidomos faktin se këta udhëheqës komunal janë të zgjedhur drejtëpërdrejtë nga qytetarët.

Ndërsa në anën tjetër duke debatuar lidhur me Qarkoren Buxhetore zëvendësministri i MF-së z.Isni Kilaj tha se jemi të vetëdijshëm se ka problem lidhur me Qarkoren e dytë Buxhetore por kjo është situata, ky është buxhet i mundësisë dhe jo i nevojave tona. Kaq ndarje buxhetore mund të ketë. Ky veprim është bërë bazuar në faturën e shpenzimeve të muajit qershor. Ndërsa shumica e ndryshimeve mund të bëhen në nivelin horizontal dhe mes kodeve operative por jo në kategoritë e pagave.

Kryetari i AKK-së z.Ismajli tha se ne si komuna kemi parasysh mundësitë dhe obligimet ndaj partnerëve ndërkombëtar financiar, por neve nuk na lejon ligji të miratojmë ligj me deficit. Kur dihet fakti se me këtë qarkore kemi 10.874.929 euro minus për paga.



Në këtë takim debatuan edhe kryetari i komunës së Podujevës z.Agim Veliu, kryetari i komunës së Junikut z.Agron Kuçi, kryetari i komunës së Vushtrrisë z.Bajram Mulaku, kryetari i komunës së Graçanicës z. Vladeta Kostić, kryetari i komunës së Rahovecit, z.Idriz Vehapi, kryetari i komunës së Lipjanit z.Imri Ahmeti, si dhe nënkryetar e përfaqësues tjerë komunal, të pranishëm në këtë takim.



Konkluzionet e takimit:

- Të rishikohen kriteret për ndarjen e mallrave dhe shërbimeve si dhe subvencioneve, dhe propozimi konkret ishte që të caktohet një kriter i njëjtë për të gjitha komunat prej 2.5 euro për kokë banori
- Mos të kufizohet rrjedha e parasë se gatshme nga Thesari për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje, me arsyeshmërinë e tyre se në të gjitha komunat ka minus në paga për stafin aktual sipas listës së pagave në Thesar.
- Subvencionet në bujqësi të rriten për arsye se strategjia e zhvillimit lokal nëpër komuna është orientuar në zhvillimin e bujqësisë (kryetari i komunës së Vushtrrisë).
- Komuna e Vushtrrisë kërkon të rritet kategoria e mallrave dhe shërbimeve për arsye se në bashkëpunim me MZHE do të hartojnë projekt për menaxhimin e mbeturinave.
- Të rishikohet niveli total i projekcionit të të Hyrave vetanake komunale, ngase mundësia e realizimit të tyre është pesimiste, duke marrë parasysh analizat se inkasimi i të hyrave vetanake nga Tatimi në Pronë është më i ulët për arsye të vonësës së hyrjes në fuqi të Ligjit për faljen e borxheve.
- Të rishikohet kufiri total i kategorisë ekonomike mallra dhe shërbime në mes të Nivelit Qendror dhe Nivelit Lokal, kur dihet se shumica e shërbimeve dhe aktiviteteve zhvillohen në nivel lokal, bazuar në analizat e buxhetit historik deri aktual 2015. Planifikimi i buxhetit për lehonitë

të bëhet në nivel të qeverisë si rezervë e veçantë, e jo të caktohet shuma përkatëse për komuna në formulën e arsimit, ngase është e pa mundur të bëhet një planifikim i saktë i tyre.

- Të lejohet fleksibiliteti për komunat mbi shpërndarjen e shpenzimeve operative dhe kapitale (mallëra dhe shërbime-komunali-subvencione-kapitale), duke përjashtuar kategorinë ekonomike paga dhe mëditje.

- Të definohet çështja për mbulimin e minusit në paga dhe mëditje për vitin 2016, ku si bazë plani i rrjedhës se parasë së gatshme nga Thesari dikton ndarjen 1/12 për paga dhe me automatizëm do të reflektojë minusi për secilin muaj deri në fund të vitit 2016.

- Lidhur me bartjen e kompetencave nga Niveli Qendror në Nivel Lokal përmes memorandumeve të mirëkuptimit të definohet financimi i tyre i qëndrueshëm në të ardhmen, të bazuar në kërkesën e MPMS për transferin e shërbimeve rezidenciale nga MPMS në 7 komunapër vitin 2016.

- Bazuar në rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm dhe kërkesave të komunave planifikimi i ndarjeve buxhetore të bëhet në përputhje me planin kontabël, si psh: mirëmbajtja e rrugëve (dimërore/verore), objekteve etj të planifikohet tek mallrat dhe shërbimet dhe jo në kapitale.

- Mospajtime lidhur me rezultatin zyrtar të numrit të popullsisë, si kriter bazë për ndarjen e grantit qeveritar për komuna.

- Të njoftohen komunat lidhur me draft Strategjinë për Financat Lokale si dhe të organizohet një Forum i përbashkët për diskutim dhe ofrimin e komenteve përkatëse, përfshirë ministritë përgjegjëse të linjës MASHT, MSH, MAPL, MPMS, etj.

- Të mos ndalohen procedurat për punësimin në rastet kur ato pozita janë aprovuar nga nivelki qendror.

- Të krijohet një Fond i veçantë për pushimet e lehonave.

- Të ndryshohet modeli i hartimit të buxhetit, psh në sektorin e arsimit të mos kalkulohet më numër të arsimtarëve por me norma mësimore.



Asociacioni i Komunave të Kosovës ka bërë nominimin e kandidatëve të komunave për anëtarë të Bordeve të Ndërmarrjeve Publike të Ujit

Pas ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike Nr.03/ L-087 dhe miratimit të Rregullores mbi kriteret për krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe pjesëmarrjen e Komunave në Bordet e Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, ka filluar procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të Bordeve të NP-ve.

Bazuar në Rregulloren Nr.02/ 2013 mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe pjesëmarrjen e Komunave në Bordet e Ndërmarrjeve Rajonale të ujit, neni 8 – Procedurat e nominimit dhe zgjedhjes së kandidatëve të komunave në Bordet e Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me komunat përkatëse, nominoi pjesëmarrësit e Komunave në Bordet e Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, me listën kryesore prej 3 kandidatësh (për secilen Ndërmarrje Rajonale), përfshirë edhe kandidatin nga komuniteti joshumicë dhe listën rezervë prej 3 kandidatësh (për secilen Ndërmarrje Rajonale), përfshirë edhe kandidatin nga komuniteti joshumicë.

Kandidatët, në bashkëpunim me komunat, u nominuan për:



Kompania e Ujitjes 'Drini i Bardhë', Sh.A. Kompania e Ujitjes Radoniqi-'Dukagjini', Sh.A. Kompania Rajonale e Ujësllësit "Prishtina", Sh.A. Prishtinë, Kompania Rajonale e Ujësllësit 'Hidrodrini', Sh.A. Pejë, Kompania Rajonale e Ujësllësit 'Hidroregjioni Jugor', Sh.A, Prizren, Kompania Rajonale e Ujësllësit 'Mitrovica', Sh.A., Mitrovicë, Kompania Rajonale e Ujësllësit 'Hidromorava', Sh.A., Gjiilan dhe Kompania Rajonale e Ujësllësit

'Radoniqi', Sh.A, Gjakovë.

Vlen të ceket se të gjithë kandidatët nga lista për intervistim që më parë është dërguar për nominim në Asociacionin e Komunave të Kosovës do të vlerësohen nga komisioni gjatë intervistimit, përfshirë edhe kandidatet e nominuar. Komisioni gjatë intervistimeve të kandidatëve të nominuar nga Komunat do të ketë parasysh referencat që i'u janë dhënë kandidatëve kryesor dhe tek më pastaj atyre rezervë.

Shkurtimisht

- Më 02.09.2015- AKK-ja mori pjesë me dy përfaqësues në takimin të radhës së Grupit Punues të Shtyllës së Dytë – Sundimi i Ligjit - grup që është duke punuar rreth hartimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim).
- Më 8 shtator 2015 – përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në takimin në Qeveri- Agjencioni për Barazi Gjinore (AKK-ja i dha propozimet veta rreth fushës së barazisë gjinore dhe prezentoj aktivitetet për të ardhmen në bashkëpunim me projektin DEMOS).
- Përfaqësuesi i AKK-së më 29 shtator mori pjesë në takimin me projektin DEMOS- (ku u diskutuan aktivitetet tona dhe mundësitë për organizimin e disa aktiviteteve së bashku nga fusha e financave, punës së Kuvendeve të Komunave, hartimit të akteve nënligjore dhe fushës së shërbimeve publike).
- Nga 30 shtatori deri më 2 tetor 2015, AKK-ja mori pjesë në punëtorinë për hartimin e "Projekt-rregullores për mbrojtjen e fëmijëve nga dukuritë negative".

REAGIM: NDAJ VENDIMIT TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR SHPENZIMIN E MJETEVE FINANCIARE NË VLERË PREJ 500.000 EURO PËR FONDIN PËR KUADRO NË NIVEL QENDROR

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS KËRKON NDERPRERJEN E RITJES SË KOMODITETIT NË NIVEL QENDROR DHE KTHIMIN E VËMENDJES NDAJ KOMUNAVE

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka analizuar me vëmendje vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës ku është marrë vendimi (i cili ka qenë i pezulluar në janar të vitit 2015) për kthim në fuqi të Fondit për kuadro ku me automatizëm do të “shpërblehen” zyrtar të Qeverisë Qendrore me ngritje të pagës dhe ku ky shpenzim në total për këtë vit do të jetë në vlerë prej 500.000 EURO. Ky vendim konsiderohet që është marrë në kohën kur komunave të Kosovës për vitin 2016 do t’iu shkurtohen buxhetet komunale në kategoritë: paga dhe medijtje, subvencione, investime kapitale etj.



Duhet të theksohet që vetëm për paga dhe medijtje komunave të Kosovës do t’i shkurtohen buxhetet në vlerë prej 10.874.929 EURO. AKK-ja konsideron që Qeveria e Kosovës duhet në mënyrë shumë më serioze t’i marrë në konsideratë vërejtjet dhe kërkesat e kryetarëve të komunave rreth çështjeve të adresuara në Qeverinë e Kosovës, përkatësisht në Ministrinë e Financave.

Në asnjë mënyrë nuk mund të lejohet një veprim i tillë pra, ngritja e pagave për zyrtar qeveritar dhe shtimi i komoditetit në nivel qendror, kur në komuna kemi shkurtime buxhetore të larta të cilat ndikojnë në deficitin e pagave në arsimin filior dhe të mesëm dhe me këto buxhete komunave iu lejohet ofrimi i shërbimeve minimale ndaj qytetarëve dhe duke mos marrë parasysh në asnjë mënyrë situatën alarmante në komuna në planin e investimeve si dhe pagave dhe medijtjeve të cilat do të shkaktojnë probleme shumë serioze në funksionim e pushtetit lokal në tërësi e në veçanti sistemit arsimor dhe shëndetësor në nivel lokal.

AKK-ja shtron edhe disa pyetje. Vallë a nevojitet fondi i kuadrove në mënyrë ekskluzive vetëm për nivelin qendror duke e anashkuar nivelin lokal në tërësi si institucion i cili është më afër qytetarit? A thua që nevoja për ngritjen e pagave vetëm të nivelit qendror do e përmirësoj jetën e qytetarit të Kosovës? A thua që zyrtarët në nivel qendror janë shumë më të ngarkuar me punë se zyrtarët në nivel lokal?

Me këtë rast, AKK-ja propozon që mjetet e dedikuara për fondin e kuadrove të rialokohen dhe të destinohen për investime nëpër komuna dhe që Qeveria e Kosovës të mos i anashkalojë insitucionet lokale në marjen e vendimeve që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me jetën e qytetarit.

Me nderime, Naim Ismajli - Kryetar i AKK-së

Kolegjiumi për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Kolegjiumi për Shëndetësi organizoi takimin me qëllim diskutimi dhe ndërmarrjen e hapave të mëtutjeshëm të reagimit duke marrë për bazë pranimin e shkresës zyrtare nga Ministria e Shëndetësisë të cilës i është bashkëngjitur kopja fizike e aktit të Ministrit të Shëndetësisë, i ashtuquajturit Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare. Me këtë rast anëtarët e Kolegjiumit shprehën shqetësimin e tyre lidhur me këtë çështje si dhe konsideruan se është i nevojshëm konsultimi dhe kërkesa zyrtare për sqarimin lidhur me përmbajtjen e këtij akti nënligjor që e ka përcjellë Ministria e Shëndetësisë komunave të Republikës së Kosovës. Përkundër faktit se Asociacioni i Komunave të Kosovës ka qenë i përfaqësuar në grupin punues, në versionin e fundit të punuar për draftimin e këtij udhëzimi administrativ, grupi punues ka rënë dakord dhe ka përpiluar modelin e statutit të QKMF-ve i cili do të paraqitet si aneksi i këtij akti nënligjor. Mirëpo udhëzimi administrativ i cili është përpiluar nga grupi punues, pra UA 02/2015 për Organizimin, përcaktimin e shërbimeve dhe veprimtarisë të institucioneve të Kujdesit Primar Shëndetësor-KPSH-së është publikuar dhe në të nuk është përfshirë aneksi i modelit të statutit të QKMF-ve. Përkundrazi, Ministria e Shëndetësisë ka vendosur që aneksin e draftuar ta nxjerrë në cilësi të akti të veçantë nënligjor. Meqenëse akti në fjalë nuk gjendet i publikuar as në ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe as në ueb faqen e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës, mbi bazën e materialit që u është dërguar komunave, Kolegjiumi pas një debati konstatoi se një rregullim i tillë cenon në mënyrë të drejtpërdrejt kompetencat komunale, që

me ndërhyrjen në kompetencat e Kuvendeve të Komunave, që kanë statusin e organit përfaqësues të pushtetit lokal dhe si themeluese të Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare, jo vetëm se bëhet ndërhyrja në aspektin e autorizimit të këtij organi që të rregullojë dhe themelojë institucionin i cili ofron shërbime publike shëndetësore, por me këtë ndërhyrje ndikohet edhe potenciali financiar i pushtetit lokal. Edhe duke e marrë parasysh që të gjitha të hyrat e krijuara nga ofrimi i shërbimeve shëndetësore në këto institucione konsiderohen si të hyra vetanake, e të cilat menaxhohen në bazë të Ligjit për Financat Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal. Si përfundim i kësaj teme doli rekomandimi që ti dërgohet shkresë zyrtare përmes kanaleve zyrtare të Asociacionit të komunave të Kosovës, Ministrit të Shëndetësisë z. Rrahmani dhe zyrës ligjore të Kryeministrit, që të bëjë edhe një herë vlerësimin dhe shfuqizimin e këtij akti nënligjor i cili bie ndesh me kompetencat komunale sipas ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Po ashtu sa i përket diskutimeve të projektligjit për mbrojtje të fëmijës i sponsorizuar nga zyra e kryeministrit, Kolegjiumi konsideroi shumë të rëndësishëm përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave komunale përmes përfaqësuesit të saj në dhënien e rekomandimeve në këtë grup punues. Duke marrë për bazë angazhimin dhe profesionalizmin në punë, Kolegjiumi për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale autorizoi si përfaqësues të saj z. Vehbi Mujku i cili edhe do të raportojë për ecurinë dhe ndryshimet eventuale në kornizën ligjore për mbrojtje të fëmijës.

Kolegjiumi për Administratë dhe Udhëheqësit e Personelit

Asociacioni i Komunave të Kosovës konsideroi me interes organizimin e takimi të përbashkët të kolegjiumit të administratës lokale dhe udhëheqësve të personelit në komuna me qëllim bashkërendimin e qëndrimeve në dhënien e rekomandimeve sa i përket diskutimit të projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Në takim po ashtu ishin pjesëmarrës edhe zyrtarë nga Departamenti Ligjor të Ministrisë së Administratës Publike si sponsorizues të këtij projektligji. Duke konsideruar se projektligji është i një rëndësie të veçantë në përcaktimin e nj sistemi efikas të menaxhimit me qëllim organizimin e nj shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, ku edhe përcakton rregullat për administrimin e shërbimit civil të Kosovës. Përkundër vërejtjeve dhe sugjerimeve nga ana e përfaqësuesve komunal, Kolegjiumi konsideroi



se të gjitha rekomandimet e dala nga ky takim të përcillen në mënyrë zyrtare nga Asociacioni i Komunave të Kosovës përmes shkresës e cila do ti përcillet Ministrisë së Administratës Publike respektivisht zyrës ligjore me të gjitha rekomandimet nga ana e AKK-së.

Kolegjiumi për Arsim



Kolegjiumi për Arsim në kuadër të aktiviteteve të veta organizoi takimin e rregullt të saj me 7 Tetor 2015, me qëllim vazhdimin punës së përbashkët me partnerët e saj në diskutimin e temave aktuale në fushën e arsimit. Duke marrë parasysh bashkëpunimin e deritanishëm me organizatat partnere në fushën e arsimit, edhe këtë herë përfaqësuesit e programit GIZ-CDBE ishin pjesëmarrës në takim me qëllim prezantimin e aktiviteteve në ngritjen e aftësive udhëheqëse përmes programeve trajnuese në udhëheqje arsimore për mësimdhënës, drejtorë shkollash si dhe drejtorive komunale sa i përket ngritjes së kapaciteteve në sektorin e arsimit në Kosovë, ku këto plane do të përdoren për të filluar procesin e planifikimit të arsimit të integruar në nivel komunal. Duke marrë parasysh rëndësinë e bashkëpunimit në takimin e përbashkët pjesëmarrës ishte edhe Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z. Arsim Bajrami i cili theksoi rëndësinë e Kolegjiumit si një mekanizëm i rëndësishëm konsultativ i cili ndihmon në koordinimin e politikave lokale më ato qendrore në avancimin dhe ndërtimin e politikave sa më të mira në fushën e arsimit. Ndër të tjera Ministri Bajrami vlerësoi se synimi i përbashkët duhet të jetë krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm për ngritjen e cilësisë në shkolla duke filluar nga Kurrikula, avancimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies, mësimi elektronik dhe vlerësimit sa më të mirë të performancës. Një rëndësi të veçantë MASHT-i do të ketë sa i përket zhvillimit të arsimit profesional sipas përshtatjes së nevojave të tregut të punës, ku edhe bëri të ditur nënshkrimin e marrëveshjes për bashkëpunim në këtë fushë me Ministrinë e Arsimit të Shqipërisë dhe atë të Maqedonisë në mënyrë që të ndihmojnë në furnizim me tekste shkollore.

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës edhe një herë ngriti shqetësimin në lidhje me shkurtimin buxhetor për komunat sidomos në grantin e arsimit ku komunat ballafaqohen me mungesë të mjeteve financiare, dhe si pasojë shqyrtimin e mundësive në zvogëlimin e paraleleve dhe shkurtim të vendeve të punës në sektorin e arsimit. Andaj kjo le të jetë një vërejtje serioze jo vetëm për MASHT-in por edhe të gjithë Qeverinë e Kosovës. Edhe përkundër vështirësive komunale në aspektin e buxhetit Ministri Bajrami sqaroi se do të kërkojë rishikimin e ligjit për Buxhet në mënyrë që të mos ketë probleme me buxhetin për arsim në mënyrë që të mos ketë zvogëlim të numrit të nxënësve për shkak të formulës, normave të punës duke respektuar parimin e përgjithshëm të qeverisë në mos shkurtimin e vendeve të punës.

Si përfundim Ministri i Arsimit bëri të ditur po ashtu informatën se Projektligji i Punëtorëve të Arsimit 1990/ 99 është përcjell në Qeverinë e Kosovës dhe se është duke u punuar në Projektligjin e Inspektoratit të Arsimit.

Shkurtimisht

- Më 6 tetor 2015- përfaqësuesi i AKK-së ka marrë pjesë në cilësinë e anëtarit të grupit punues për hartimin e Projektligjit për banim social. Gjatë muajit tetor janë mbajtur katër takime tjera, ku u vlerësua se qëllimi i ligjit është përcaktimi i kriterëve, procedurave, kompetencave dhe përgjegjësive financiare rreth ndërtimit të objekteve për banim social dhe përzgjedhjes së përfituesve për banim social.

- Më 7 tetor 2015 – përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në takimin e rregullt të Këshillit të Turizmit të Kosovës në MTI (ku u diskutua mundësia për ndryshimit e ligjit të turizmit, u raportua në Këshill puna e Divizionit të Turizmit dhe u dhanë propozime rreth planit të punës së Këshillit).

- Më 20 tetor 2015- përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në takim në Ministrinë e Financave - grupi punues për decentralizim fiskal (u diskutuan tri dokumentet e hartuar nga ekspertet e projektit 1. Zhvillimi Rregullave Fiskale për Komuna; 2. Granti i Përgjithshëm dhe 3. Të Hyrat Vetanake).

- Më 21 tetor 2015 - përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në takimin e organizuar nga Agjencioni për Barazi Gjinore, ku u prezentua Ligji i ri për Barazi Gjinore (ndryshimet kryesore në ligjin e ri kanë të bëjnë me përfaqësimin e barabartë mes dy gjinive 50 % mashkuj dhe 50 % femra, buxhetimi gjinor dhe masat ndëshkuese).

- Më 29 tetor 2015- përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në takimin e Ministrisë së Drejtësisë, grupin teknik 2, për hartimin e Strategjisë Kombëtare për të Drejtat Pronësore (çështja që ndërlidhen me komunat është prona komunale, ku AKK-ja do të organizojë takime të veçantë mes zyrtarëve të komunave dhe ekspertit për hartim të Strategjisë, sa i përket shtyllës së dytë të Strategjisë).

Kolegjiumi për Integritime Evropiane

Me qëllim të bashkërendimit të punëve në kuadër të agjendës evropiane, si dhe rritjen e koordinimit midis institucioneve qendrore dhe komunale veçanërisht për të diskutuar për çështjet që ndërlidhen me procesin e integritimit evropian të Kosovës, Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoi takimin e rregullt të Kolegjiumit të zyrtarëve komunal për Integritime Evropiane.

Po ashtu me qëllim informimit të gjendjes aktuale në komuna sa i përket procesit të integritimeve evropiane, në takim ishte prezent zëvendësministri i Ministrisë së Integritimit Evropian z. Ramadan Ilazi i cili vlerësoi punën dhe angazhimin e ZKIE-ve, ku kërkoi vazhdimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit me qëllim të bashkërendimit të punëve në kuadër të agjendës evropiane si dhe rritjen e koordinimit midis institucioneve qendrore dhe komunale. Në vazhdim zëvendësministri Ilazi, ka informuar të pranishmit me zhvillimet e fundit, me fokus Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) si dhe procesin e liberalizimit të vizave, ku ndër të tjera kërkoi nga zyrtarët komunal për integritime evropiane që të ndërmarrin iniciativa lidhur me zhvil-

limin e aktiviteteve të ndryshme në komuna me qëllim të informimit të qytetarëve se çfarë nënkupton liberalizimi i vizave, në mënyrë që të shmangen keqkuptimet që ekzistojnë tek qytetarët për sa i përket këtij procesi. Më tej Kryesuesja e Kolegjiumit bëri prezantimin për sa i përket fuqizimit të rolit të zyrtarëve komunal për integritime evropiane në komuna me theks rëndësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit të Komunave në ndërmarrjen e disa aktiviteteve të përbashkëta me ministrinë e linjës dhe donatorët në realizimin e programit për fushën e integritimeve evropiane, e ku ndër të tjera shprehu edhe shqetësimin e kolegjiumit. Lidhur me Katalogun e Punës në Shërbimin Civil të Kosovës, e ku kjo pozitë sipas ZKIE-ve zbeh rolin dhe pozicionin e tyre. Zëvendësministri morri përsipër të kontaktoj me MAP, lidhur me pozitën e ZKIE, në mënyrë që të qartësohet pozita e tyre në komuna, si dhe kërkoi nga Komunitat që të përgatisin disa projekte të vogla deri në fund të vitit që kanë të bëjnë me integritime evropiane e që do të mbështeten nga Ministria e Integritimit Evropian.

Implementohen tri projektet në komunat fituese të ‘Skemës BEACON’

Projekti i identifikimit dhe shpërndarjes së praktikave të mira “Skema BEACON”, i mbështetur nga GIZ-i dhe i implementuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës është në përfundim e sipër. Si rezultat i këtij projekti, me praktika të mira aplikuan 19 komuna me 22 aplikacione.

Nga këto, 11 aplikacione ishte për praktika të mira në fushën e menaxhimit të mbeturinave, 2 në ndriçim publik, 4 në gjelbërim e mjedis, 1 task force për mjedis, 1 për rregullim shtrati të lumit, 1 në përmirësim të shërbimeve publike komunale, 1 në trotuare / ndriçim / kontenjerë nëntokësor dhe 1 aplikacion për mirëmbajtje e rrugëve dhe ndriçimi i tyre. Siç dihet nga këto aplikacioni, Komisioni i Ekspertëve të GIZ-it ka vlerësuar tri praktika më të mira në fushën e shërbimeve publike, Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëra – Komuna e Gjilanit, Task Forca Komunale për Mjedis – Komuna e Gjakovës dhe Ndriçimi Publik – Komuna e Ferizajit.

Ndërkohë, me propozimin e vetë komunave, është bërë investimi deri në 7000 euro për këto komuna si tri praktikat më të mira komunale në fushën e shërbimeve publike. Projektet e investuara si formë shpërblimi e të cilat janë përfunduar janë: Hapja e pusit në Parkun “ILIRIA” dhe sistemi i Ujitjes te parku i qytetit, Rr."Bulevardi i Pavarësisë" në komunën e Gjilanit, “Rregullimi i parkut përballë Teqes së Bektashinjve” në komunën e Gjakovës dhe “Rregullimi i ndriçimit në Rr. e Qiragjinjëve -

Fsh.Nikadin” në Komunën e Ferizajit.

Poashtu Asociacioni i Komunave të Kosovës ka organizuar edhe punëtorinë për shpërndarjen e këtyre praktikave edhe tek komunat tjera si njëri ndër synimet e vetë projektit.



Komuna e Prishtinës po e udhëheq procesin e reformës administrative

“Progresi është i mundur” është ajo çfarë tha Kryetari i Nju Jorkut, z. Bloomberg pas reformimit të suksesshëm të administratës së qytetit. Prishtina, me mbështetje nga GIZ-ja, tani është duke e ndjekur këto hapa të mëdhenj duke e zbatuar një reformë administrative, si një parakusht për të ofruar shërbime më të mira: Struktura administrative e Departamentit të Shërbimeve Publike, Departamentit të Administratës dhe Zyrës së Kryetarit të Komunës janë reformuar me sukses në procesin e ofrimit të shërbimeve efikase, të tilla si një proces bazë i standardizuar për ndërtimin e rrugëve, për trafikun urban, për menaxhimin e mbeturinave dhe kështu me radhë. Kështu, Korniza Evropiane e Menaxhimit të Cilësisë (EQMF) është zbatuar me sukses, fillimisht përmes kryerjes së një vlerësimi, duke e zhvilluar një plan veprimi strategjik me masa përkatëse dhe në fund duke i implementuar proceset e reja të standardizuara ISO. Tani, Komuna për synim e ka certifikimin ISO. Kjo reformë e menaxhimit të cilësisë, tani është edhe duke u pilotuar në të gjitha ndërmarrjet publike të mbeturinave (NP-të) nëpërmjet mbështetjes PAMKOS nga GIZ-i. NP-të kanë rënë dakord në proceset standardizimit dhe në ndarjen e praktikave më të mira tek kolegët e tyre. Përmes standardizimit, dokumentacionit, dhe sasisë së proceseve të punës, ne do të rrisim transparencën dhe llogaridhënien në katër ndërmarrje më të mëdha të shërbimeve publike. GIZ-ja do të vazhdojë të ofrojë mbështetje për Pejën, Mitrovicën dhe Gjilanin që kanë shprehur interes të instalojnë në mënyrë të barabartë procese më efikase administrative duke e aplikuar menaxhimin kualitativ.



Drenasi dhe Mitrovica i kanë zgjeruar dhe përmirësuar shërbimet e mbeturinave për qytetarët e tyre



“Ishim të detyruar t’i djegim mbeturinat sepse era e tyre gati i sëmuri fëmijët tanë”, shpjegoi një nënë, “Tani ne e kemi një kontejner dhe Uniteti (ofruesi i shërbimit nga komuna e Mitrovicës) çdo javë vjen dhe i mbledh mbeturinat”, shtoj ajo. Të mbështetur nga GIZ-ja qytetarët e fshatrave Çikatova e Vjetër, Baicë dhe Llapushnik të komunës së Drenasit dhe të fshatrave Kçiq i Madh dhe Kçiq i Vogël në Mitrovicë tani i gëzojnë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.

Qytetarët e kanë fituar besimin në komunat e tyre. Në Drenas, mbulimi i mbeturinave është rritur nga 47% në 2014 në 60% në vitin 2015 dhe është ende në rritje. Në muajt në vijim, në mënyrë të ngjashme edhe Komuna e Mitrovicës do të ja shtojë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave edhe në pesë fshatra tjerë. Të dy komunat kanë ndërmarrë shumë hapa të suksesshëm për t’i përmirësuar situatat e tyre të mbeturinave me qëllim të ofrimit të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave në të gjitha fshatrat, në këtë mënyrë duke e arritur - hap pas hapi - një normë të mbulimit prej 100%.



KRYETARË TË KOMUNAVE TË EVROPËS JUGLINDORE DO TË DISKUTOJNË SHËRBIMET PUBLIKE GJATË KRIZËS SË REFUGJATËVE

Zagreb, 30 Shtator 2015 - "Sfidat dhe ndikimi i krizës së refugjatëve për Qeverisjen Lokale në Evropën Juglindore", ishte tema e diskutimit e organizuar nga Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS), me mbështetjen e Bashkëpunimit të Gjermanisë për Zhvillim (GIZ) dhe Bashkëpunimit të Zvicrës për Zhvillim (SDC), me 2 tetor 2015 në Zagreb, Kroaci. Në këtë takim nga Asociacioni i Komunave të Kosovës morën pjesë edhe z.Naim Ismajli – Kryetar dhe z.Sazan Ibrahim – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së. Kryetarë dhe punonjës të komunave të Kutinës, Tovarnikut, Zabokut, Njemcit (Kroaci) Kanjizes, Paraçinit, Preshevës (Serbi), Kumanovës (Maqedoni), Kahramanmarasit dhe Stambollit (Turqi) reflektuan mbi eksperiencën dhe praktikën e tyre në përballjen me fluksin e refugjatëve deri tani, do të identifikojnë

masat, metodat dhe procedurat urgjente duke pasur parasysh kompetencat lokale dhe çështje për tu adresuar në situata të tilla si dhe do të diskutojnë për mundësi të bashkëpunimit dhe koordinimit rajonal. Takimi do të ndiqet dhe nga përfaqësues të komunitetit të donatorëve për të diskutuar nevojat për mbështetje dhe masat urgjente.

Qytetet kufitare në Evropën Juglindore po përballen me një fluks të madh ditor të refugjatëve nga Siria, fluks që në shumë raste tejkalon dhe popullsinë e këtyre qyteteve. Kjo ka sjellë dhe mjaft sfida të reja për qeverisjen lokale. Nga njëra anë, qeveritë lokale po punojnë paralelisht me qeverinë qendrore, organizatat humanitare dhe të tjera për të mbështetur dhe ofruar trajtimin e nevojshëm për refugjatët. Nga ana tjetër, qeverisja lokale duhet të vazhdojë të ofrojë shërbime me një cilësi të lartë për një popullsi të rritur

INFO...
Gjatë muajve shtator dhe tetor, të gjitha projekt-strategjitë, projekt-ligjet, projekt-rregulloret dhe projekt-udhëzimet administrative janë përcjellur te Kolegji-umeve Profesionale të AKK-së për të dhënë rekomandime, plotësime apo vërejtje.

ndjeshëm, në një situatë të infrastrukturës të varfër publike e të trashëguar. "Ky takim nuk është thjesht një konferencë tjetër", thotë z. Emil Draghici, President i NALAS-it dhe Kryetar i Komunës Vulcana-Bai, Rumani. "Ky takim duhet të jetë një diskutim i hapur në mes dhe me kryetarë të komunave të prekura më shumë nga kjo situatë. Një diskutim për situatën aktuale në të cilën ndodhemi, për të kuptuar sfidat me të cilat ata përballen dhe së bashku të bëjmë një plan veprimi afatshkurtër se si Asociacionet tona të Qeverisjes Lokale dhe rrjeti i tyre NALAS, në bashkëpunim me partnerë të tjerë, t'i ndihmojmë këto Komuna të përballojnë problemin".

NALAS-i sjell së bashku 16 Asociacione të cilat përfaqësojnë afërsisht 9000 njësi të qeverisjes lokale, të zgjedhur drejtpërdrejtë nga më shumë se 80 milionë banorë të këtij rajoni. NALAS-i nxit procesin e decentralizimit, kontribuon në procesin e stabilizimit dhe pajtimit duke kontribuar kështu dhe në integrimin evropian për të gjithë rajonin. NALAS-i ndërmerr dhe zbaton nisma rajonale për anëtarët dhe ndihmon asociacionet të bëhen përfaqësuese të afta të njërive lokale në raport me qeverinë qendrore. NALAS-i ofron shërbime për njësitë lokale në përfitim të qytetarëve të rajonit përmes Qendrës së Njohurive për Zhvillim të Qeverisë Lokale në Evropën Juglindore, e njohur dhe nga të gjitha palët e interesuara të kësaj fushe.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

BULETINI

Viti XII. Nr. 74 • Shtator - Tetor 2015

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: info@komunat-ks.net

Web: www.komunat-ks.net

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacion i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

